



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300824/5

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandim për ekzekutimin e vendimit nr. 651 (62-2023-2194), datë 05.06.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku vendoset se shtetasi I. B. duhet të vazhdojë masën mjekësore "mjekim i detyruar spitalor", duke urdhëruar kurimin e tij në një institucion mjekësor të specializuar, jashtë sistemit të IEVP-ve.*

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER**

**Për dijeni:** **MINISTRISË SË SHËNDETËSISË**  
Komitetit Kombëtar për Shëndetin Mendor

**MINISTRISË SË DREJTËSISË**  
Komisionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

**GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM FIER**

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur jeni njohur me ankesën e shtetasit R. B., i cili ka ngritur shqetësimin se nuk po zbatohet Vendimi nr. 651 (62-2023-2194), datë 05.06.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier<sup>1</sup>, ku është caktuar se shtetasi I. B. (djali i ankuesit) duhet të vazhdojë masën mjekësore “*mjekim i detyruar spitalor*”, në një institucion mjekësor të specializuar (jashtë sistemit të I EVP-ve), sipas praktikës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Shtetasi I. B. vazhdon të mbahet në I EVP Lezhë.

Në vendimin e gjykatës, i cili na është vënë në dispozicion nga ankuesi, rezulton se: shtetasi I. R. B. ka kryer veprën penale “*Dhuna ne familje*” në dëm të nënës së tij, shtetases S. B. dhe ndaj tij është caktuar fillimisht masa mjekësore “*Mjekim i detyruar spitalor*” me vendimin nr. 22, datë 22.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Kjo masë është rishqyrtuar periodikisht nga gjykata, e cila ka caktuar vijimin e saj. Në këto kushte, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ka rishqyrtuar sërish masën mjekësore për shtetasin I. B., çështje e regjistruar në datën 19.12.2022, dhe për të arritur në një përfundim objektiv mbi gjendjen e shëndetit mendor të këtij shtetasi, ka kërkuar ekspertim psikiatrik-ligjor, pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë. Përfundimet e ekspertit mjeko-ligjor janë parashtruar në aktin e ekspertimit nr.335, datë 15.05.2023 ku thuhet se:

- Shtetasi I. B. vazhdon të prezantojë simptomatikë aktive të sëmundjes, prej së cilës vuan;
- Bazuar në vlerësimin e shtetasit I. B., klinikën aktuale të sëmundjes, mungesën e kritikës ndaj sëmundjes dhe për pasojë edhe mungesën e komplaincës me terapinë, ndaj tij rekomandohet vazhdimi i masës mjekësore “*Mjekimi i detyruar në institucionin mjekësor*”;
- Aktualisht, ku simptomatika e sëmundjes është e pastabilizuar, shtetasi I. B. vazhdon të prezantojë risk, i cili është i pamënaxhueshëm për sjellje të paparishikueshme.

---

<sup>1</sup> Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 05.07.2023.

Për sa i përket institucionit ku shtetasi I. B. duhet të qëndrojë me masën mjekësore “*mjekim i detyruar spitalor*”, në pjesën arsyetuese të vendimit thuhet se: “*institucioni psikiatrik duhet të ofrojë një trajtim më të specializuar dhe efektivitet më të lartë në përmirësimin e gjendjes mendore të shtetasit I. B., përmes observacionit të vazhdueshëm nga ana e stafit, ku të mundësohen edhe vizitat e familjarëve të tij*”. Gjyqtari i çështjes citon praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut<sup>2</sup>, raportet e institucionit të Avokatit të Popullit të viteve 2015 dhe 2016 dhe raportet e Komitetit European për Parandalimin e Torturës të viteve 2017 dhe 2018, ku janë konstatuar problematikat lidhur me kushtet materiale dhe trajtimin e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor. Duke u bazuar në këto raporte, gjykata ka vendosur që shtetasi I. B. duhet të vijojë masën mjekësore “Mjekim i detyruar spitalor” në një institucion mjekësor të specializuar (jashtë sistemit të I EVP-ve), sipas praktikës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në kuadër të hetimit tonë administrativ për të trajtuar shqetësimin e ngritur nga ankuesi, me shkresën tonë Nr.K2/R6-2 Prot., datë 26.09.2023, kemi kërkuar pranë institucionit tuaj, të informohemi lidhur me masat e marra për ekzekutimin e vendimit në fjalë.

Bashkëlidhur shkresës tuaj Nr.13353/1 Prot., (E.A.), datë 08.09.2023, na është dërguar urdhri i ekzekutimit të vendimit penal nr. 651 (62-2023-2194), datë 05.06.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku urdhërohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e tij, dhe shkresa nr.9326/2 Prot., datë 21.09.2023, drejtuar I EVP Lezhë, ku sqarohet ky institucion se, në kushtet e mungesës së një institucioni mjekësor të posaçëm, personat me çrregullime të shëndetit mendor, do të trajtohen në I EVP Lezhë, si një institucion tranzitor. Ju shpreheni gjithashtu se, shtetasi I. B. i cili vuan nga çrregullime të

---

<sup>2</sup> Çështja “Dybeku kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 411153/06, vendimi i datës 18.12.2017 dhe çështja “Strazimiri kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 34602/16, vendimi i datës 21.01.2020.

shëndetit mendor, është i dyshuar për një veprë penale dhe për këtë arsye nuk mund të mjekohet në institucione mjekësore, jashtë sistemit të IEVP-ve.

Qëndrimi ynë i fundit institucional lidhur me çështjen e trajtimit të të burgosurve me probleme të shëndetit mendor, është dhënë në rekomandimin e dërguar me shkresën nr.K4/I8-2 Prot., datë 23.03.2022, drejtuar: Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, si dhe për dijeni Kryeministrit. Në vijimësi kemi sjellë në vëmendje se, personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata ka vendosur masën “mjekim i detyruar” apo “shtrim i detyruar”, duhet të trajtohen në një institucion të posaçëm mjekësor, pjesë e sistemit shëndetësor dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar. Kjo do të ishte zgjidhja e përshtatshme për ofrimin e shërbimit të nevojshëm shëndetësor ndaj këtyre personave në mënyrë që t’u ofrohen programe gjithëpërfshirëse të vlerësimit, trajtimit dhe rehabilitimit të tyre. Deri në ngritjen e institucionit të posaçëm mjekësor, kemi rekomanduar:

- 1. Të merren masa të menjëhershme, për miratimin sa më parë të strukturës organike të IEVP Lezhë, bazuar në një studim të qartë dhe konkret të kryer nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, për të shtuar kapacitetet e shërbimit mjekësor dhe shërbimeve mbështetëse të këtij institucioni, me qëllim rritjen e cilësisë të shërbimeve ndaj personave me masë mjekësore.*
- 2. Të merren masa të menjëhershme, në kuadër të investimeve të Qeverisë Shqiptare për Rindërtimin, të cilat janë planifikuar për t’u kryer për rikonstrukcionin e godinave të tjera në territorin e IEVP Lezhë, të ndërtohet dhe përshtatet dhe njëra prej godinave, për shkak të rritjes së numrit të personave me masë mjekësore me çrregullime të shëndetit mendor, që ndodhen në institucionet e sistemit penitenciar.*

3. *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, bazuar në Planin e Përbashkët të Veprimit për trajtimin e personave me masë mjekësore, të detajojnë aktivitete specifike me afate kohore konkrete për këta persona, sipas angazhimeve të marra në marreveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.*

Po ashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Vendimet nr. 255, datë 19.12.2018 dhe nr. 46, datë 28.03.2019, e ka konsideruar trajtim diskriminues mbajtjen në IEVP të personave që i përkasin kategorisë të sëmurëve të shëndetit mendor dhe i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të marrë masa sa më parë për ngritjen e një institucioni të përshtatshëm për këta persona.

Për sa i përket qëndrimit të institucionit tuaj lidhur me trajtimin e këtij rasti, duke mosvënë në zbatim një vendim gjyqësor të formës së prerë sipas përcaktimeve të tij, e konsiderojmë në kundërshtim me disa akte normative dhe konkretisht:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 142/3, ku parashikohet se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.*

2. Kodi i Procedurës Penale, respektivisht nenet 24/1<sup>3</sup>, 462/1<sup>4</sup>, 463/1<sup>5</sup> dhe 464<sup>6</sup>, ku parashikohen detyrimet e prokurorit për të vënë në ekzekutim vendimin penal të gjykatës pasi të ketë marrë formë të prerë.

---

<sup>3</sup> Në nenin 24/1 të Kodit të procedurës Penale parashikohet se:

Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, **merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre**, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

<sup>4</sup> Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë.

<sup>5</sup> Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, merr masa për ekzekutimin e vendimit. Ai bën kërkesa në gjykatën kompetente dhe ndërhyr në të gjitha veprimet e ekzekutimit.

<sup>6</sup> Në nenin 464 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

1. Për ekzekutimin e një vendimi me burgim, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit.

3. Ligjin Nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, respektivisht nenet 8<sup>7</sup>; 11/1<sup>8</sup>; 23/4/5<sup>9</sup> dhe neni 56<sup>10</sup>, ku parashikohet detyrimi prokurorit për të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji.

Neni 4 i Ligjit Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” sanksionon se: *“Mbrojtja dhe promovimi i shëndetit mendor kryhen nëpërmjet masave që kontribuojnë në sigurimin ose rivendosjen e ekuilibrit mendor të individit, duke fuqizuar kapacitetet individuale, duke promovuar integritetin, duke përmirësuar pranimin dhe duke luftuar diskriminimin e stigmën në mjedisin social të tij”.*

Një nga masat që kontribuojnë në sigurimin ose rivendosjen e ekuilibrit mendor të këtyre individëve, shprehet në parimin e përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 5 të këtij ligji, ku thuhet se: kujdesi shëndetësor për personat me

---

2. Urdhri i ekzekutimit përmban gjeneralitetet e të dënuarit, dispozitivin e vendimit dhe disponimet e nevojshme për ekzekutimin.

3. Kur i dënuari është i paraburgosur, urdhri i dërgohet organit shtetëror që administron burgjet dhe i njoftohet të interesuarit, ndërsa kur i dënuari nuk është i paraburgosur urdhërohet burgimi i tij.

4. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për rastet e ekzekutimit të vendimeve të mbylljes së detyrueshme në institucione mjekësore ose edukimi.

<sup>7</sup> Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit penal në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji, si dhe të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit. Në rast të konstatimit të parregullsive, prokurori ka të drejtë t’i kërkojë organit përgjegjës ose gjykatës rivendosjen e të drejtës së shkelur, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.

<sup>8</sup> Prokurori merr masa dhe vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal dhe, në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale, procedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit, sipas këtij ligji.

<sup>9</sup> 4. Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe kriterëve të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, prokurori përcakton llojin e institucionit ku i dënuari do të kryejë dënimin dhe në konsultim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve përcakton institucionin konkret.

5. Kur gjykata nuk e ka konstatuar dhe prokurori ka të dhëna se është vendi për vendosjen në institucione mjekësore të posaçme, ai urdhëron kontrollin mjekësor të të dënuarit dhe, kur ka arsye, në bazë të rezultateve, i paraqet kërkesë gjykatës sipas parashikimeve ligjore.

<sup>10</sup> Në nenin 56 të Ligjit Nr. 79/2020 parashikohet se:

1. Për personin e papërgjegjshëm që ka kryer një vepër penale, masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet sipas vendimit të gjykatës në institucionin mjekësor të specializuar të përcaktuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

2. Me urdhrin e ekzekutimit të prokurorit, dërgimi në institucionin mjekësor i personit që dyshohet se ka kryer një vepër penale kryhet: a) nga institucioni mjekësor që e ka në trajtim; b) nga institucioni mjekësor me ndihmën e Policisë së Shtetit, kur kërkohet nga mjekët që e kanë në trajtim; c) nga Policia e Shtetit në rast se i dyshuari i lirë nuk ekzekuton urdhrin vullnetarisht.

3. Masa mjekësore me mjekim të detyruar ambulator ekzekutohet në institucionet mjekësore të vendbanimit të të detyruarit. Kur në to nuk ka specialistë përkatës, shoqërohet në çdo rast nga këto institucione në rrethin më të afërt ku ka të tillë.

4. Kur gjatë ekzekutimit të kësaj mase sillen pengesa nga i detyruari, prokurori urdhëron ekzekutimin e detyruar nga Policia e Shtetit dhe, kur është vendi, i paraqet kërkesë gjykatës për ndryshimin e masës në mjekim të detyruar në një institucion mjekësor të specializuar.

çrregullime të shëndetit mendor, ofrohet në një mjedis sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjet nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*".

### **REKOMANDOJMË :**

Marrjen e masave nga organi i prokurorisë për ekzekutimin e vendimit nr. 651 (62-2023-2194), datë 05.06.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku është vendosur se shtetasi I. B. duhet të vijojë masën mjekësore "mjekim i detyruar spitalor", duke urdhëruar kurimin e tij në një institucion të specializuar (jashtë sistemit të IEVP-ve), sipas praktikës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**